

RAPORT PARAPRAKË

VLERESIM NDIKIMI NË MJEDIS

(SHTOJCA II, PIKA 10, a/b)

PROJEKTI: NDERTIMI I INFRASTRUKTURËS KABLLORE, HFC, F.O (RRJETEVE TE TELEKOMUNIKACIONIT) SI DHE MENAXHIMI I RRJETEVE TE TELEKOMUNIKACIONIT PER TE OFRUAR SHERBIMET INTERNET, TELEVISION DIGITAL DHE TELEFONE

VENDODHJA E ZONES SE ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS: BASHKIA BERAT, RRETHI BERAT, QARKU BERAT

KËRKUESI: "ABCOM" SHPK



TIRANË/ MAJ 2015

Informacion mbi Projektin:

Titulli i projektit: Ndertimi i infrastruktures kabllore, HFC, F.O (rrjeteve te telekomunikacionit) si dhe dhe menaxhimi i rrjeteve te telekomunikacionit per te ofruar sherbimet internet, televizion digital dhe telefone

Vendodhja e projektit Bashkia Berat, Rrethi Berat, Qarku Berat

Emri i raportit: Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (Procedura paraprake)

Subjekti aplikues ABCOM.Sh.p.k

Bashkëautor: Ing. Ilir Robo

Ing. Mjedis. Façona Levani

Data e këtij raporti:

Tiranë, Maj 2015

Aprovuar:

Ilir Robo

ILIR ROBO
ING. ILIR ROBO
SPEC. I MJEDISIT
Nr 125 ÇERTIFIKA

(Ekspert i çertifikuar nga MM me nr. 125 Regj. Nr. 136 Prot, Date 12.05.2005)

Tabela e raportit paraprake te VNM:

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME	3
1.1 Përshkrimin e projektit të propozuar, te cilin e kemi pergatitur dhe bashkeemeluar "Pershkrimi i projekt zhvillimit" te gjitha dokumentat me nenzera perkatese te perfshira ne ku perfshihen keto informacione dhe te dhena teknike si:	7
1.2 Përshkrim i shkurtër për kapitujt e Raportin paraprak te VNM-se, ku perfshihen:.....	8
Fazat e procedurës paraprake të VNM-së: Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", dhe kalon në këto faza të njëpasnjëshme:	8
2. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE	9
2.1 Përshkrimi i përgjithshëm mbi rajonin e Bashkisë Berat	9
2.2 Vlerat ekologjike (flora dhe fauna) ne rajonin e Bashkisë Berat dhe per zonen ne vleresim:.....	15
3. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.	18
3.1 Hidrologjia e rajonit te Qarkut Berat	18
Gjeomorfologjia.....	19
3.2 Zona ne vleresim ku do te zhvillohet projekti i infrastruktures se rrjetit fabllor HFC	21
4. IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PULHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA,	22
4.1. Ndikimet e mundshme mjedisore	22
5. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË	29
6. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;	31
6.1. Rehabilitimi mjedisit te ndikuar nga ndertimi i rrjetit inxhinierik	31
7. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;.....	33

RAPORT PARAPRAKË / VLERËSIMIT TËNDIKIMIT NË MJEDIS

Ndërtimi i infrastruktures kablore, HFC, F.O (rjeteve te telekomunikacionit)

Bashkia Berat

8. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).....	39
9. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.	42

LISTA E HARTAVE, TABELAVE

Tabele nr. 1: 1 Fotove te zones se Bashkise Berat.....	17
Tabele nr. 2: Lista e kontrollit te efekteve te mundshme dhe masave kryesore nga zhvillimi i projektit.....	34
Harta 1:Harta e shtrirjes se projektit te ABCOM ne rajonin e Bashkise Berat.....	4
Harta 2:Harta e vendodhjeve te zonave te banuara perreth projektit.....	30
Harta 3:Ndikimet e mundshme nderkufitare.....	39

SHKRUTIME

VNM: Vleresim ndikimi ne mjedis

P.A: Parqe arkeologjik

MM: Ministria e Mjedisit

AKM: Agjensia Kombetare e Mjedisit

MBZHRAU: Ministria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave

GIS: Sistemi gjeografike i informacionit

PPV: plan i pergjithshem vendor

AKPT: Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME

Ky raport paraprak VNM se bashku me kerkesen dhe dokumentacionit shoqëruës nga ana e kerkuesit "Abcom"Shpk, do te paraqiten në Ministri te Mjedisit (MM) e cila do te percjell dokumentacionin në AKM per marrjen e Vendimit nga AKM per nenshtimit te procedurave paraprake te VNM per projektin: **NDERTIMI I INFRASTRUKTURES KABLLORE, HFC, F.O (RRJETEVE TE TELEKOMUNIKACIONIT) SI DHE DHE MENAXHIMI I RRJETEVE TE TELEKOMUNIKACIONIT PER TE OFRUAR SHERBIMET INTERNET, TELEVISION DIGITAL DHE TELEFONE**, me vendodhje ne Berat, Bashkia Berat, Rrethi Berat, Qarku Berat.

Kerkuesi Abcom.SHPK, që synon të pajise me Vendim AKM për procedure VNM paraprake kete projekt qe do te ndertohen sipas Kontrates se Sipemarrjes qe do te nenshlohet me subjekte ndertues ku objekti i kontrates te zbatohet me perpiktmeri sipas studimit te realizuar nga grupi projektues i kontraktuar nga kerkuesi.

Kerkuesi "ABCOM", kerkon te dorezoj kete **RAPORT PARAPRAK TE VNM-se** per miratim me Vendim te AKM te per:

Projektin e infrastruktures: Ndertimi i infrastruktures kabllore, HFC, F.O (rjeteve te telekomunikacionit) si dhe dhe menaxhimi i rjeteve te telekomunikacionit per te ofruar sherbimet internet, televizion dig tal dhe telefone

Vendodhja: Berat, Bashkia Berat, Rrethi Berat, Qarku Berat.

Ky projekt per shtimin e rrethit kabllor nentokesor dhe ajeror HFC do te zhvillohet pergjate rrugeve te brendshme sekondare dhe aksa kryesore te Bashkise Berat, brenda zones se zhvillimit te ndertimeve dhe zones se urbanizuar. Zgjidhja optimale e projektit te siguron sherbim me teknologji e me sigurim teknik. Mbetjet e ndertimit ne pergjithesi do te grumbullohen gjithashtu me komcditet e me cilësi te larte sigurie gjate fazes se ngarkim – shkarkimit te materialeve te ndertimit nga mjetet e tonazhit te rende.



Harta 1: Harta e shtrirjes së projektit të ABCOM në rajonin e Bashkisë Berat

Në vijim paraqesim koordinatat e shtrirjes së projektit si më poshtë shënuar:

Koordinatat e shtrirjes së projektit të Abcom, Bashkia Berat

Nr	Kordinata Gjeografike	Kordinata UTM
1	40°42'59.19"N	4507820
	19°56'25.92"E	410515
2	40°42'55.62"N	4507707
	19°56'35.62"E	410742
3	40°42'39.99"N	4507228
	19°56'26.23"E	410516
4	40°42'22.87"N	4506668
	19°56'33.27"E	410675
5	40°42'21.79"N	4506665
	19°56'31.81"E	410635
6	40°42'14.55"N	4506440
	19°56'38.32"E	410790

RAPORT PARAPRAKË I VLERËSIMIT TËNDIKIMIT NË MJEDIS

Ndertimi i infrastruktures kablore, HFC, F.O (rrjeteve te telekomunikacionit)

Bashkia Berat

7	40°42'16.45"N	4506493
	19°56'58.72"E	411269
8	40°42'23.80"N	4506719
	19°57'1.29"E	411333
9	40°42'27.25"N	4506826
	19°56'58.34"E	411265
10	40°42'31.22"N	4506947
	19°57'0.31"E	411313
11	40°42'22.17"N	4506665
	19°57'14.69"E	411646
12	40°42'25.51"N	4506765
	19°57'25.55"E	411903
13	40°42'24.60"N	4506736
	19°57'27.51"E	411948
14	40°42'16.73"N	4506495
	19°57'23.48"E	411850
15	40°42'11.14"N	4506314
	19°57'49.36"E	412456
16	40°42'14.57"N	4506415
	19°58'11.59"E	412979
17	40°42'17.87"N	4506515
	19°58'13.67"E	413026
18	40°42'16.53"N	4506472
	19°58'21.62"E	413215
19	40°42'12.71"N	4506354
	19°58'21.17"E	413203
20	40°42'10.72"N	4506290
	19°58'33.41"E	413490
21	40°41'55.82"N	4505834
	19°58'21.98"E	413213

RAPORT PARAPRAKË I VLERËSIMIT TËNDIKIMIT NË MJEDIS

Ndërtimi i infrastruktures kablllore, HFC, F.O (mjetëve të telekomunikacionit)

Bashkia Berat

22	40°41'59.02"N	4505934
	19°58'15.26"E	413060
23	40°41'51.52"N	4505707
	19°57'58.64"E	412667
24	40°41'41.76"N	4505402
	19°58'13.40"E	413009
25	40°41'35.26"N	4505208
	19°58'1.88"E	412737
26	40°41'35.26"N	4505208
	19°57'52.27"E	412511
27	40°41'38.91"N	4505323
	19°57'41.58"E	412262
28	40°42'7.55"N	4506213
	19°57'18.91"E	411740
29	40°42'14.25"N	4506423
	19°57'6.83"E	411459
30	40°42'10.42"N	4506317
	19°56'22.44"E	410416
31	40°42'13.01"N	4506399
	19°56'15.18"E	410246
32	40°42'23.56"N	4506727
	19°56'5.20"E	410016
33	40°42'41.12"N	4507270
	19°56'0.80"E	409920
34	40°42'52.94"N	4507634
	19°56'3.38"E	409984
35	40°42'59.12"N	4507821
	19°56'13.78"E	410231
36	40°42'55.14"N	4507696
	19°56'22.79"E	410440

Projekti ne vleresim (Ndërtimi i infrastruktures kabllore, HFC), pjesë që i takon të ndërtohet nga subjekti ndërtues për zbatim të projektit që do të nenkontraktohet nga ABCOM.Sh.p.k, i cili është subjekti i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, SHTOJCA II(Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis), pka 10. Prodhime infrastrukturore, nenpika (a,b) a)Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale; b)Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat; kërkohej që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidësë), paraqet pranë MM, dhe dokumentacionin përkatës, i cili përmban:

1.1 Përshkrimin e projektit të propozuar, të cilin e kemi përgatitur dhe bashkeemëruar "Përshkrimi i projekt zhvillimit" të gjitha dokumentat me nenëza përkatëse të përfshira në ku përfshihen këto informacione dhe të dhëna teknike si:

- a) përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar(relacioni teknik)
- b) planimetria e vendndodhjes së projektit ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit (projekti+genplan i zonës ku do të shtrihet projekti i Abcom Berat);
- c) informacioni për cendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna) që administron territorin ku propozohet projekti (Raporti i VNM);
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit (Projekt)
- d) përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit (programi i punimeve+preventivi i punimeve);
- dh) informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbejtjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja(Sqarim në raportin e VNM);
- e) programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit (programi i punimeve);
- ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit nuk do të ketë ndërtim por shtrijë të rrjetit në një linjë ekzistuese pa ndikuar në punime ndërtimore të prishjeve të objekteve ekzistuese);
- f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (raport i VNM);
- g) informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pra në zonës së projektit (Raport i VNM)
- gj) informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret (Raport i VNM);
- h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre(Preventivi i punimeve);
- i) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj;
- j) informacioni për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit (Kërkesa e subjektit +dokumentacioni teknik+kërkesa për kontrollin e përputhshmërisë).

RAPORT PARAPRAKË / VLERËSIMIT TËNDIKIMIT NË MJEDIS

Ndertimi i infrastruktures kablore, HFC, F.O (rrezeve te telekomunikacionit)

Bashkia Berat

1.2 Pershkrim i shkurter per kapitujt e Raportin paraprak te VNM-se, ku përfshihen:

Ky raport paraprak i VNM eshte pergatitur ne perputhje me Vendimit e Keshillit te Ministrave Nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të Vendimit dhe Deklaratës Mjedisore" ku specifikisht Kreu I Zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis)si me poshte sqaruar:

Fazat e procedurës paraprake të VNM-së: Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"i ndryshuar, dhe kalon në këto faza të njëpasnjëshme:

- a) Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues nga zhvilluesi në MM e cila e perçjell në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- b) Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera dhe publikimi i kërkesës;
- c) Marrja e vendimit nga AKM-ja, njoftimi i AKM, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të konsultuara, si dhe publikimi i vendimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave te AKM.

Raportin paraprak te VNM-se, ku përfshihen:

Kapitulli 1: Te dhena te pergjithshme per projektin

Kapitulli 2: Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me imazhe;

Kapitulli 3: Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Kapitulli 4: Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin o mjetjeve;informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Kapitulli 5: të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Kapitulli 6: mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendje më parshme, përfshi edhe kthimin e tokës bujqësore (në rast se përdorimi ekzistues është i tillë) dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Kapitulli 7: masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Kapitulli 8: ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

Kapitulli 9: certifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së, të specialistit që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

2. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE

2.1. Përshkrimi i përgjithshëm mbi rajonin e Bashkisë Berat

Qyteti i Beratit është i vendosur në Shqipërinë Jug-Qendrore në rrethin e Beratit , i cili ka një sipërfaqe prej 939 km² dhe popullsi prej 65 mijë banorë. Berati është një ndër qytetet më të vjetër të Shqipërisë dhe ka një trashëgimi kulturore unike, tashmë pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Është një qendër e rëndësishme për zhvillimin e turizmit në vend.

Klima – Rajoni i Beratit ka një klimë tipike mesdhetare . Klima favorizon zhvillimin e agro-biznesit lokal, të cilat shihen me shumë rëndësi për zhvillimin ekonomik të qytetit.

Demografia – Burimet njerëzore të qytetit e pozicionojnë atë si një qendër të rëndësishme për zhvillimin ekonomik për të gjithë vendin. Shumica e popullsisë është në moshe pune dhe ka një numër të lartë të popullsisë në moshe të re.

Qeverisja lokale- Bashkia e Beratit formon pjesë të rrethit me të rrejtin emër dhe është qendra e rajonit të Beratit. Këshilli Bashkiak , i cili është një organ vendimarrës për qeverisjen lokale, ka 35 anëtarë , ndërsa Kryetari i Bashkisë është i votuar direkt nga populli. Institucioni i Bashkisë ka rreth 127 punonjës .

Buxheti i bashkisë – Të ardhurat kryesore për bashkinë janë buxhetet si nga të ardhurat lokale dhe grantet qendrore. Qeverisja lokale përcakton prioritetet në bazë të .

Strategjia social ekonomike e qytetit :*Prioritetet e zhvillimit*

1- Zhvillimi në rajonin e Beratit i agrobiznesit dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet përdorimit të potencialëve në prodhim dhe marketing.

2- Zhvillimi i turizmit në Berat duke shfrytëzuar trashëgiminë e tij unike historike dhe kulturore.

3- Zhvillimi i mjedisit urban të Beratit në përputhje me parametrat bashkëkohore dhe në harmoni me specifikat e qytetit .

Profili ekonomik i Beratit-Bizneset lokale , veçanërisht prodhuese , duan të zhvillohen dhe të zgjerohen duke përdorur resurset natyrore të rajonit dhe avantazhet gjeografike me efektivitet dhe efience të lartë. Bizneset me baze turizmin shfrytëzojnë trashëgiminë historike dhe arkitektike të qytetit . Bizneset artizanale , megjithëse të vogla dhe të zhvilluara brenda familjes , duan të mbajnë traditat gjalle dhe të zgjerohen në nivel kombëtar dhe ndoshta në tregjet ndërkombëtare . Ndërsa bizneset tregtare po riformojnë profilin e tyre .

Baza kryesore mbi të cilën bazohet ky zhvillim , pëveç traditave dhe faktorëve të listuar më sipër , është zgjerimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në biznese të mëdha dhe ndryshimet në strukturën e biznesit , të fokusuar në Berat përgjithësisht në shërbimet e agrobiznesit, hotelet dhe turizmit.

Agrobiznesi & Artizanati--Agrobiznesi është më i zhvilluari dhe akoma një sektor premtues për zhvillimin e ardhshëm të Beratit , i cili reflektohet në numrin e tyre (41) të cilat operojnë sot në sektorin e agrobiznesit dhe territori që mbulojnë koto (23.5 % të sipërfaqes së përgjithshme), numri i njerëzve të punësuar në këtë sektor (42.3 % e totalit të të punësuarve) dhe përben (49 %) të numrit total të bizneseve .

Për më tepër disa produkte të caktuara agro-bujqësore si ullinjte, fiqte dhe qershite kanë qenë të kultivuara në Berat për mijëra vjet, duke zënë rreth 13 % të zonës bujqësore të qytetit. Në vijim të agrobiznesit, artizanali është një prioritet tjetër i zhvillimit ekonomik të Beratit dhe do të stimulohet nëpërmjet ruajtjes dhe kultivimit të traditës dhe nëpërmjet prezantimeve në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare .

Ka shumë biznese të tjera aktive në Berat , përfshirë industrinë që procedojnë me produktet ushqimore, të mishit , pijet alkoolike dhe jo alkoolike , ndërsa disa industri të manufakturës po tërhojnë investime si ato të industrisë së lehtë, ajo e materialeve të ndërtimit , punimet me dru , etj.

Plani i menaxhimit te bashkise ka si synim disa objektiva :

- 1-Objektivin kulturor
- 2- Objektivin ekonomik
- 3- Objektivin social

Objektivi kulturor –Hyra e Beratit ne lsten e trashegimise boterore do te kerkoje nderhyrje specifike persa i perket ruajtjes se trashegimise kulturore . Qyteti vete dhe qeveria shqiptare duhet te investojne ne fushen kulturore . Si mjedhoje trashegimia kulturore do te jete me mire e mbrojtur dhe e vleresuar. Qyteti do te marte shume perfitime , vecanerisht persa i perket organizimit dhe imazhit te tij publik.

Objektivi ekonomik -Perrmiresimi i trashegimise kulturore do te ketë rezultate pozitive : nje mije te turizmit (me mjedhoje mijeve te disa fushave te ekonomise) dhe mijeve te gjitha aktiviteve te lidhura me vete ruajtjen e trashegimise (nderhyrje restauruese, riorganizime arkitektonike dhe mjedisore) .

Objektivi Social -Hapja e aktiviteve te reja te punes ne qendren historike, te lidhura me trashegimine kulturore , artizanatin dhe turizmin, do te reduktojne emigracionin. Restaurimi i shtepive historike ne zonat e vjetra do t'u jape mundesine qytetareve te zhvillojne "turizmin familjar".

Avantazhet kryesore te bashkise Berat–Berati ka nje pozicion gjeografik te favorshem per instalimin e nje infrastrukture moderne dhe te kompletuar. Vendndodhja e tij,mjedisi gjeografik ,arkitektura dhe trashegimia e tij artistike e bojne qytetin terheqes per turistet dhe te pershtatshem per zhvillimin e nje cilesie jete te mire per qytetaret e tij.

Rajoni ka nje klima tipike mesdhetare , e cila ben te mundur zhvillimin e bujqesise si nje baze e rëndësishme e zhvillimit te agrobiznesit. Siperfaqja totale prej rreth 23 km² , nga e cila 6 km² eshte urbane dhe rreth 2 km² eshte toke bujqesore , mbashtet kiene e zhvillimit te bujqesise lokale.

Berati eshte qyteti i shume muzeumeve dhe monumenteve te artit dhe kultures , te cilat se bashku kane nje vlerë unike , duke e bere qytetin terheqes per turistet vendas dhe te huaj .Jane rreth 108 monumente te kultures ne qytet dhe lagja Mangalem eshte vendi i nje kompleksi unik arkitekturor .Kalaja e qytetit ka shume objekte te rëndësishme kulturore, muzeun Kombetar Onufri te ikonografise , sikurse nje arkitekture unike e cila ka terhequr vemendjen e studiuvesve vendas dhe te huaj. Lagja Gorice pjese e qendres historike eshte nje kompleks muzeal me nje rëndësi arkitektonike duke perbere nje pasuri natyrore dhe historike per qytetin.

Perreth qytetit eshte nje hapësire e pershtatshme per perqendrimin e bizneseve brenda zones okzituose industriale dhe per perrmiresimin e zones per zhvillimin e agrobiznesit. Vendndodhja e zones e ben ate te pershtatshme per ngritjen e nje tregu agrobiznesi .

Distancat nga Berati drejt porteve ,aeroporit dhe qyteteve te tjera kryesore ne Shqiperi jane te aferta duke lehtesuar komunikimin.

Zhvillimi ekonomik ne shekuj: Fillezat e themelimit dhe organizimit të Beratit, lidhen me shekullin e katërt para Krishtit. Ai përshkruhet si një vendbanim tradicional dhe historik me interes të veçantë.Vlerat e tij pasqyrohen nga studiuves të shumtë si të pallogaritshme.Për zhvillimin ekonomik-social të Beratit në periudha të ndryshme të ekzistencës së tij, dëshmon fondi i pasur i muzeut etnografik të këtij qyteti. Në stendat dhe "dyqanet" e këtij muzeu gjë material të zbuluara që fillojnë nga periudha e bronzit, në atë të hekurit, të periudhës antike , të mesjetës e deri në ditët e sotme. Zejet kanë qënë një traditë e hershme e këtij qyteti. Në vlerësimet e tij udhëtarit dhe studjuesi i mirënjohur i shekullit XVII, Evliha Çelebi, ka përmëndur veprat e djemve berates në qëndistari, për nga bukuria ,mahnitëse e prodhimeve të tyre. Krahas qëndistarisë zhvillim të dukshëm kanë pasur në Berat edhe prodhimet artizanale të kujunxhinjeve (punimi i anit, argjendit dhe zbukurimet me to), kazanxhinjeve, xhokaxhinjeve (veshje burash me lesh të destiluar),qpingarëve,samarxinjëve,teneqexhinjëve,dyfelokxinjëve,kundraxhinjeve,lëkurxhinjëve,takijexhinjeve,s araqëve,kalldrëmshinjeve,shajakpunuesve,poçarëve (prodhuuesve të enëve dhe dekoracioneve prej balte) artistëve të gdhëndjes së gurit dhe drurit dhe punuesve të zhukës dhe shelgut për prodhime të nevojave jetike dhe dekorative. Të gjithë aktivitetet e zejtarëve beratas kanë qënë të perqëndruara në Pazarin e qytetit me shtrirje nga dyqanet e Mangalemit tek Xhamia e Beqarit, nga Xhamia Mbret , tek Xhamia e Plumbit dhe

RAPORT PARAPRAKË / VLERËSIMIT TËNDIKIMIT NË MJEDIS

Ndërtimi i infrastruktures kablore, HFC, F.O (mjeteve te telekomunikacionit)

Bashkia Berat

buzë lumit Osum (në lulishten e sotme pranë shëtitores së qytetit). Në dyqanet e këtij Pazarit jo vetëm prodhohej por edhe tregëtohej. Në mjediset e brendshme të Pazarit ndodheshin tregjet e bulmetit, të misrit dhe bagëti. Për efekte reklame shumë fise beratase krahas mbiemrit të trashëguar mbanin edhe mbiemrin e vepërmarive që ushtronin. Kështu mund të gjejmë edhe sot fise qytetare me mbiemrat Xhokaxhiu, Kalkdrëmoxhiu, Samanxhiu, Kazazi (mendafshounues), Tabaku, Saraci, Nalboni, Poçari, Kafexhiu, Bakalli etj. Është për tu shënuar fakti që edhe në ditët e sotme disa profesione të zejtarisë artistike , prodhimit të suvenirëve dhe kulinarisë kanë marrë një zhvillim cilësor duke afimuar njëll mjeshtra dhe artistë të talentuar që aplikojnë në këtë fushë. Kulinaria e Beratit në mënyrën e saj përfshin gatime të karakterit mesdhetar, ku mbizotërojnë gatimet orientale me leng, të ferguarat (skuçurat) dhe tavat ,ndërsa në grupin e ëmbëlsirave ato me shurup Pavarësisht nga kjo , nisur nga zhvillimi ekonomik dhe social që ka pasur Berati në shekuj, arti i kulinarisë ka pësuar një transformim të vazhdueshëm në cilësi e lojshmëri duke bërë këtë treve të preferuar në të gjithë kohrat për kuzhinën e tij karakteristike dhe cilësore. Në të gjithë Shqipërinë kanë qënë me emër gatimet e ustallarëve të kuzhinës së Hysen Cafës e Mihal Boboçit, pijet e Nani Karase dhe ëmbëlsirat e Peçi Çamit. Kjo traditë u përcjua ,u pasurua dhe u zhvillua më tej nga mjeshtrat e kulinarisë beratase ndër të cilët mund të përmendim: Halit Nuredini, ish-kuzhinier pranë Konsullatës shqiptare në Rusi, Scër Ceca,kuzhinier i parë në Hotel "Kolombo" Berat, Hekuran Matrapazi, kuzhinier për priftë të personaliteteve etj.

Rrjeti i gatimeve dhe i shërbimeve në kundërvështrimin tim-Berati tradicionalisht ka patur një rrjet të gjerë tregëtar, Qeveria e Mbretit Zog e la të lirë tregëtinë. Në Berat, veç kulturës së gatimit turk dhe të Lincjes, u fut edhe kultura italiane. Pas Luftës, u mblen kërkesat e zhvillimit të rrjetit të ushqimit social,veçanërisht të njësive gjysmë të gatshme. U rit lojshmëria dhe cilësia e gatimeve. Por linte për të dëshiruar etika, reklamat dhe ambalazhi. Ajo që kishte më shumë rëndësi ishte se përdorej prodhimi vendës. Me ardhjen e demokracisë lindën marrëdhënie të reja. Pronarët e rinj mësuuan në emigracion dhe i kushtuan vëmendje paraqitjes së lokaleve dhe rëndësisë së përgatitjes së menuse. Kjo soll që lokalet e Beratit të merrnin pamje evropiane,duke patur në kujdes edhe vlerat e qytetit-muze. Fuqja e Beratit UNESCO, ka rritur përgjegjësinë e pronarëve për t'u përgjigjur kërkesave të reja të klientelës.

2.1.1. Zhvillimi arkeologjik, kulturore-historik i Bashkisë Berat

Berati është një ndër qytetet e malë, i cili i takon agimit të njerëzimit. Një kohë, kur ujrat rrëdhnin të pakontrolluara dhe shkatëruese, në këtë zonë u krijua një masiv shkëmbi, i zbuluar nga natyra në sajë të këtij lumi, i cili duket t'është vënë posaçërisht për të mirëprirur një qytet ku jeta filloi të organizohej për më shumë se 2400 vite.

Ky qytet, rezultat i fantazisë së rafinuar, tërhuqj poetët të shkruajnë dhe piktorët të pikturojnë. Qytetet si Berati kanë një gjenezë jo të thjeshtë. Periudha e para-qytetërimi zgjati gati dy mijë vjet. Zbulimi në muret e kështjellës, i dy çekanëve prej gurë dhe mbetjeve metalike (përbërë prej bakri dhe bronzit), që i përkasin fillimit të periudhës së bronzit (dy mijë vjet para Krishtit) e provojnë këtë. Zbulimet e mëvonshme të shumë pjesëve prej qeramike, tregojnë shtrimin e ngulimeve të bëra në këtë qendër, derisa në shekullin e IV para Krishtit vendi u transformua në një kështjellë në kodër djathtas lumit Osum, e cila shënoi origjinën e qytetit. Kështjella me bazamente liire, u ruajt në shekuj dhe në shekujt VI, XIII, XV e XIX u modifikua. Si i tillë ajo nuk është vetëm një ndër kështjellat më të mëdha të banuara, por edhe një arkiv gurësh, i cili ofron një varietet stileshe e kontributesh të epokave të ndryshme, si asaj Romane, Bizantine, Shqiptare e Otomane. Gjithmonë së njëjtës periudhë (shekulli IV para Krishtit) i përket edhe një tjetër kështjellë ajo e Goricës, e pozicionuar në kodrën përballë, duke krijuar një fortifikim të dyfishtë në të dy anët që zbrasin drejt lumit. Rezultat i këtij fortifikimi nuk ka qënë vetëm mundësia për të dominuar zonën, por edhe për efekt dekorativ për pamjen: kodrat ngjajnë si mbretër me kurorat mbi koka, të formuara nga kështjellat e bardha.

Historia duhet të ketë përqendruar këtu drama dhe tragjedi. Duke qënë një nga qytetet më të rëndësishëm të mbretërisë liire, u banua nga një tribu e madhe: Dasaretët. Gjatë luftave liiro-Romake dhe Maqedonase-Romake qyteti u mor një herë nga maqedonasit e një herë tjetër nga liirët. Është interesante të dihet se në Berat u lind Ptolema Lagosi, i biri i Filipit të Maqedonisë dhe themeluesi i dinastisë Ptolemene në Egjipt, e cila filloi pas vdekjes së Aleksandrit të Madh dhe që vjen deri në vdekjen e Kleopatras.

Në vitin 200 pas Krishtit qyteti u dominua nga romakët. Qyteti i fortifikuar u identifikua me Antipatrean nga Polibi në vitin 216 para Krishtit. Me të njëjtin emër e quan më vonë Tit Livi, që e përshkruan si qytet i madh e i fuqishëm i fiksuar në një qafë të ngushtë shkëmbore. Livi tregon edhe për Igësinë e konsullit romak, i cili lu kundërvu me agësi qytetarëve të cilët nuk i përulëshin, «...vrau të gjithë nga gjashtëmbëdhjetë vjeç e lart, lejoi që ushtria të vidhte, të shkatëronte muret e t'i vinte hakurat dhe zjarin qytetit». Për sa i përket emrit të qytetit ekziston edhe një tjetër hipotezë: emërtimi i qytetit antik me emrin Bargul. Ky emër përmendet edhe nga Tit Livi kur flet për traktatin Romako-Maqedonas të vitit 205 para Krishtit, nënshkruar në qytetin e Dimalit. Ky emër, i cili në gjuhën ilire do të thotë i bardhë, mbahet më vonë në traditën bizantine dhe slavo, ndërsa emri tjetër, Antipatreia, u përmend nga Dasaretët, që sot është zona midis Korçës dhe Pogradecit. Romakët e quajtën qytetin edhe Albanorum Oppidum (Fortesa e shqiptarëve). Në vitin 148 para Krishtit qyteti u përfshi në provincën romake të Maqedonisë, ndërsa gjatë Diklecianit (shekulli II pas Krishtit) në provincën e Epirit të Ri. Emri Pulkeriopolis u shfaq në shekullin e V, nga emri i motrës së perandorit të Lindjes Teodosi II. Ky emër, Pulcheria, që do të thoshte i bukur, i fortë, i pasur, i ndritshëm, iu dha qytetit jo pa qëllim: qyteti po bëhej në fakt një kryeqendër dhe shfaqte një nivel të lartë kulturor, dhe dëshmi siç janë kodikët e famshëm të Beratit, të cilat përkasin kësaj periudhe. Me kalimin në Mesjetë, filloi një periudhë e errët edhe për Beratin. Qyteti të tjera të vogla shqiptare zhduken. Berati mbeti vetëm një hapësirë e gjorë: fusha para dhe malet pas. Qyteti mbijetoi vetëm falë rrethit murgor të Shqipërisë së Mesme rreth Beratit, por edhe për pozicionin gjeografik, sepse është pika në të cilën bashkohet fusha me malet, pozicion i cili siguron agrikulturë dhe biegtori. Megjithatë kushtet e mbylljes së ekonomisë, Berati vazhdoi të zhvillohej, dhe filluan të shfaqen raportet e tipit feudali. Në vitin 860 në Berat filloi periudha e invazionit bulgar, i cili zgjati deri më 927, derisa u rikthye dominimi Bizantin, i cili vazhdoi deri në fund të vitit 969. Pas kësaj filloi menjëherë invazioni i dytë bulgar, i cili u largua përfundimisht në vitin 1018. Invazioni bulgar, në fazën e dytë, e pagëzoi Beratin me emrin Belgrad, fortesa e bardhë. Përveç kësaj transformimi të emrit, qyteti nuk pësoi të tjera transformime nga ana e bullgarëve. Pas rënies së mbretërisë bulgare (1018) qyteti luajti rolin e një qendre të rëndësishme. Fakt u bë edhe ietra e viteve 1098-1105 e Theofilakti i Chrit një ndër dijetarët më të përmendur të kohës, në të cilën e përshkruan peshkopin e Beratit si «një njeri tek i cili shkëlqen dituria». Me rënien e perandorisë bizantine, Berati u bë një prej qendrave kryesore të autoriteteve religjioze të Epirit. U bë rezidenca e Mihal Engel Komnenit, Despoti i Despotatit të Epirit. Në hyrje të kështjellës, në portën jugore, gjendet një monogramë e përbërë prej gurësh, një kryq e katër gërma ku shkruhet M.H.L.K., i cili është emri i despott, M. (i) H. (a) L. K. (Omneni). Kjo mënjë e familjes së madhe bizantine të Engjëll Komnenit merr fund në vitin 1216 por, pasardhësit e tij do të mbajnë këtë emër edhe për gjysmë shekulli. Për Perandorin Bizantine, Berati ishte kaq i rëndësishëm, sa që tërhoqi menjëherë vëmendjen e Anzhuinëve të Napolit në vitin 1271. Dësfta e Anzhuinëve, të cilët kishin zaptuar qytetin për gati dhjetë muaj, u festua me gëzim të madh si në Berat, ashtu edhe në Kostandinopojë. Ngrija e Kishës së Shën Mërisë së Vllshemës, brenda Kështjellës së Beratit (një emër që të kujton palatin Perandorak të Kostandinopojës) lidhet me këtë fakt. Data e krijimit të kishës mban, në fakt, të njëjtën periudhë. Në regjistrat antikë të Beratit, të vitit 1280, gjenden të parat lajme mbi daljen e qytetit jashtë mureve të kështjellës. Nga këto tekste evidentohet që ndërtime të reja filluan edhe jashtë mureve. Rëndësia e madhe e Beratit ndihet edhe në fillim të shekullit XIV (1302-1320) kur qeveritarët e Beratit morën detyra të rëndësishme nga Bizanti; një prej tyre ishte kunati i Perandorit. Në atë kohë në Berat manifestohen shenjat e para të një revolte popullore dhe një tendencë për autonomi nga ana e latifondistëve shqiptarë. Revolta shpërtheu në vitin 1336 dhe, dhe revolta përfshiu edhe Beratin. Për të ulur revollën popullore edhe në Berat vetë Perandori. Në të njëjtën periudhë afrohet fundi i erës bizantine. Në vitin 1345-1346 Perandoria Bizantine zhduket përfundimisht nga skena politike shqiptare. Filloi dominimi i mbretit serb Stefan Dushan. Berati u vu nën mbikqyrjen e tij dhe u quajti Belgrad, edhe pse më vonë u kthye nën dominimin e Muzakaëve, një ndër familjet më të fuqishme shqiptare. Në vitin 1417 Berati u mor nga turqit. Heroi kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, mori në konsideratë rëndësinë e qytetit, e rrethoi në korrik të 1455, por ardhja e papritur e 40.000 kalorësve turq shkaktoi një humbje të rëndë. Gati të gjithë ushtarët italianë, të cilët ishin vënë në dispozicion prej Alfonsit të V të Aragonës për t'i dhënë ndihmë Skënderbeut nën komandën e Raimondo Orsatis, mbetën të vrarë poshtë mureve të kalësë.

RAPORT PARAPRAKË / VLERËSIMIT TËNDIKIMIT NË MJEDIS

Ndërtimi i infrastruktures kablore, HFC, F.O (rrjeteve te telekomunikacionit)

Bashkia Berat

Sipas regjistrit turk të vitit 1431, në Kalanë e Beratit ndodheshin 227 familje, me një total prej rreth 1500 banorë. Në shekullin XVI Berati mori zhvillim paralelisht me mijen e Perandorisë Otomane. Ndërtime të reja u bënë jashtë mureve të kalasë, në momentin e parë jug e jug-lindje, dhe më pas përgjatë anës së djathtë të lumit Osum, dhe, më në fund, përtej lumit, në anën jugore të kodrës së Goricës. Në fund të shekullit mund të numëroheshin 1019 shtëpi, me një total prej rreth 7000 – 8000 banorësh. Një zhvillim të madh mori artizanati, i cili dëshkohet nga lindja, bashkëpunimi dhe tregu i lulëzuar.

Gjatë invazionit otoman Berati mbetet një nga qytetet më të mëdha të Shqipërisë. Në fillim u bë kryeqendra e provincës, në shekullin XVIII, qendër e dominimit të Pashallëkut të Beratit, i cili më vonë i bashkohet Pashallëkut të Janinës. Dominimi i Pashallëkut të Beratit u bë shumë i rëndësishëm nën Ahmet Kurt Pashain. Deri në fillim të shekullit të XX qyteti kishte një infrastrukturë të mirë. Ishte, në fakt, një nyje lidhëse drejt Lindjes, për Kostandinopojën, por edhe drejt Jugut, për Janinën, e prej atje, për gjithë Greqinë.

Edhe Deti Adriatik u përdor si rrugë komunikimi e lejonte hapjen e rrugëve që lidhnin Beratin me qytetet e tjera; më e njohura ishte «Rruga e detit», e cila të çonte në Vlorë, dhe ajo në drejtim të Veriut, që bashkonej me lumin Shkumbin me rrugën Egnatia dhe përfundonte në Durës.

Ka hipoteza se emri Berat rrjedh nga një variant shqiptar i quajtur Belgrad, por ekziston edhe një tjetër supozim sipas të cilit emri shpjegohet nëpërmjet një dekreti (Berat), i cili në turqisht do të thotë imunitet, privilegj. Ky dekret i sulltanit Mehmet II Fatih, nuk e trajton Beratin me autoritet dhe i lejonte qytetarët të qëndronin, i njëjtit qytetarëve lirinë për të punuar, si dhe të drejtën për të mbajtur kostumet dhe zakonet e tyre.

Kalaja

Është monumenti më antik, me një sipërfaqe 9.6 ha, i cili ngrihet në një kodër 187 m të lartë, e rindërtuar disa herë gjatë periudhave të historisë. Ndodhet në pjesën e sipërme të qytetit dhe ka mure të larta rrethuese të ndara nga 24 kulla të formave dhe dimensioneve të ndryshme, të ndërtuara në periudha të ndryshme. Është ndërtuar me gurë gjigandë në formë katrori. Në periudhën bizantine kështjella ndodhej në listën e fortifikimeve të Justinianit. Muri rrethues rrethon kodrën, e cila dominon qytetin aktual të Beratit dhe ka formën e një shigjete drejtuar nga veriu, në fakt, më parë formonte një zinxhir me kodrën përballë Goricës, e cila është 6 m më e lartë.

Lumi që kish formuar, në këtë pikë, një liqen dhe shumë larg një kaskadë gërru pak nga pak shkëmbin duke formuar një grykë të ngushtë. Për këtë motiv shtati i kësaj ane është shumë i pjerrët e shkëmbor, dhe plot shkëmbinj që vështrojnë drejt qiellit.

Në pjesën e veriore në të cilën ndodhet porta kryesore, ka qënë ndërtuar një oborr i fortifikuar mirë, që është një nga ndërtimet e para të këtij loji të realizuar në mesjetë me qëllim devjimin e simeve direkte.

Në pjesën jug-lindore gjendet një sistemë uji e ndërtuar mjeshtrësisht, që ishte në gjendje të mbante ujë të freskët. Për të siguruar ujin në mesjetën e vonë, në pjesën jugore u ndërtua një galeri nëpërmjet së cilës bëhej transportimi i ujit nga lumi në kështjellë.

Në pjesën më të lartë të kështjellës ndodhet gjithashtu një akropol i rrethuar nga mure, brënda së cilës gjenden mbetjet e një garnizoni ushtarak, mbetjet e sarajeve të pashait dhe të Xhamisë së Bardhë në periudhën otomane.

Kështjella i ka qëndruar besnike planimetrisë së saj të shekullit IV para Krishtit. Hera – herës, sipas teknikave të përdorura, kështjella u përshtat, e kjo mund të vihet re në kullat e predispozura për topa dhe në frangitë për pushkët, që shfaqen në periudhën e pashallëqëve të mëdha shqiptare, të shekullit XVIII-XIX. Topat gjenden ende edhe sot përgjatë mureve të kështjellës.

Vende të tjera për të parë dhe për të vizituar

Disa kapële dhe kolona dëshmojnë ekzistencën e kishave paleokristiane në Berat në shekullin IV-VI, si për shembull bazamenti i kishës Shën Todri dhe një kolonë e vendosur kundrejt dritares së absidës. Gërmimet dëshmojnë që kisha e shekullit të XVI – XVIII është ndërtuar sipër themeleve më antike. Ndër ndërtimet më të rëndësishme midis shekullit VI-XV janë tre kisha bizantine të konservuara mirë: Shën Maria e Vlahernës dhe

Shën Triadha, në brendësi të qytetit të vjetër të fortifikuar, në anën jugore të kalasë gjendet Shën Mëhili, ndërtuar mbi një shkëmb të thepisur jashtë mureve.

Kishat në Berat janë përta të arkitekturës mesjetare. Qyteti ka qenë një qëndër e rëndësishme kishtare. Ka një numër të madh kishash (42) të ndërtuara në brendësi të kështjellës. Këtu u gjend edhe një vepër tjetër e rrafë, Epitafi i Glavenicës, (Foto) një vepër e famshme e artit të shekullit 1373, një qëndisje në ar, argjend e mëndafsh, në të cilën, me një finesë dhe plasticitet të papërsëritshëm shikohet Krishti i vdekur, me kurorën me gjëmba e rrethuar nga shkrime në greqisht.

Kishat e Beratit, të pasura me afreske të periudhës bizantine e post – bizantine, pëmbajnë vepra të autorve të ndryshëm, duke u nisur nga anonimët e shekullit XII-XIV deri tek mjeshtrit e mëdherj të shekullit XV si Onufri dhe i biri Nikola.

Nga ndërtime të kullit musliman dy prej tyre gjenden në brendësi të kështjellës: Xhamia e Kuqe (shekulli XIV) dhe Xhamia e Bardhë (shekulli XV).

